



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1138/2 Prot

Gramsh më, 12.04.2021

VENDIM
Nr. 32 datë 02.04.2021
PËR

Miratimin e vlerës financiare të familjes së shtetasit Ismet Rama, fshati Shemrizë, Njësia Administrative Pishaj, të dëmtuar nga forca madhore (tërmeti) i datës 21.09.2019 dhe 26.11.2019.

Këshilli i bashkisë në mbledhjen e tij të dates 02/04/2021, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publik, Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit : ” **Për trajtimin financiar të shtetasit Ismet Rama fshati Shemrizë, të dëmtuar nga forca madhore (tërmeti) i datës 21.09.2019 dhe 26.11.2019**”, në mbështetje të ligjit Nr.45/2019 datë 18.07.2019, ” Për mbrojtjen civile”, të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012, ”Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” kreu i III-të, të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015, ”Për vetqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1 b.

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përlllogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th. **1 900 248 x 50% = 950 124** lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Ismet Rama** është në **950 124** (nëntëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e njëzetë e katër) lekë.
3. Ti akordoj familjes së shtetasit Ismet Rama, ndihmën emergjente financiare në vlerën prej 950 124 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e njëzetë e katër) lekë nga buxheti i



bashkisë Gramsh, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë për vitin 2021.

4. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Ismet Rama, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.
5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Ismet Rama, banesa e të cilit është dëmtuar nga forca madhore (tërmeti) i datës 26.11.2019.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike (Sektori I Emergjencave Civile) si dhe Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.
7. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të Prefektit.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI

Konceptoi: Xh. Gjini
Pranoi: G. Lena
Miratoi: G. Lena
Dosja nr: _____
Afati i ruajtjes: _____

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

GRETA LENA

